



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 457/2 Prot.

Tiranë, më 26.06.2022

V E N D I M

Nr.90, Datë 26.06.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES TEMATIKE
NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL
NË INSTITUCIONIN E VARËSISË TË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT DHE PARALAJMËRIMIN E
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen tematike të zhvilluar në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 122, datë 14.10.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe në Departamentin e Administratës Publike”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

Objekti i mbikëqyrjes është tematik për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me institutin e transferimit në rastin e ristrukturimit të institucionit Agjencia Kombëtare e Bregdetit, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion filloi në datën 18.10.2021, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 987/2 prot., datë 14.10.2021, miratuar nga Komisioneri dhe me shkresën nr.987/3 prot., datë 14.10.2021, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes tematike të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit”*, u njoftua institucioni i mbikëqyrur për fillimin e këtij procesi.

Subjekti i mbikëqyrur përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, e materializuar edhe në lidhjen nr. 1 (numri rendor 27 - Agjencia Kombëtare e Bregdetit), të Vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 457 prot. datë 16.05.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë 5 ditë kohë, për të paraqitur observacionet në lidhje me gjetjet e përfshira në këtë material.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 851 prot., datë 26.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit *“Kthim Përgjigje”*, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar pa paraqitur observacione, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i mbikëqyrjes, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e*

mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes tematike, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, duhet t’i dërgojë zyrtarisht Sekretarit Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit formularin e vlerësimit të punës për titullarin e institucionit, për nëpunësin *****, i cili është anëtar i TND-së, me qëllim që të përmbillet procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, i cili nuk është realizuar në këtë rast.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të plotësojë formularin e vlerësimit të punës dhe ta dërgojë atë pranë njësisë përgjegjëse (*DAP*) me qëllim që të vijojnë procedurat e parashikuara në pikën 5, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, lidhur me vlerësimin e anëtarit të TND-së, ***** , nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatimit të nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA